



VENDIM

Nr. 7 Datë 06.02.2014

PËR
MIRATIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË KURUM INTERNATIONAL
SH.A, PËR TRANSFERIMIN E ASETVEVE TË HEC “ULËZ”-
“SHKOPET”, “BISTRICA 1” DHE BISTRICA 2” NË KUADËR TË
MARRËVESHJES ME “IFC”

Në mbështetje të neneve 9 dhe 20, pika 1 të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar; nenit 8 të Rregullores së Proçedurave e të Transferimit të Aseteve të të Liçensuarve,” si dhe pikave 1.3 dhe 1.6 të Liçensës Për Prodhimin e Energjisë Elektrike, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e datës 06.02.2014, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

Konstatohet se:

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti rezulton se janë plotësuar sipas kërkesave ligjore pikat si më poshtë:

- **Neni 7, pika 1.1 dhe 1.2**

Emri dhe adresa e plotë e të liçensuarit:

- **Neni 7, pika 1.3/”a”, “b”**

Përshkrimi i të liçensuarit dhe informacioni lidhur me aktivitetin e tij.

- **Neni 7, pika 1.3/”c”**

“Gjendja financiare në kohën kur paraqitet kërkesa dhe efekti i pritshëm pas transferimit të asetve.

Janë plotësuar gjithashtu pika 1.3/”d”, “e”, “f”, “g”, “h”, të nenit 7 të Rregullores:

- Pika 1.3/”d” - Përshkrimin e kandidatit përfitues.
- Pika 1.3/”e” -Arsyet dhe shkaku ligjor i barrësimit – motivet.
- Pika 1.3/”f” - Efektet e pritshme të transferimit (dhënies peng/hipotekë) në aktivitetin e të licënsuarit.
- Pika 1.3/”g” - Efekti në furnizimin e rregullt e të qëndrueshëm të klientëve të të licëncuarit dhe në tarifatat e aktivitetit të licënsuar.
- Pika 1.3/”h” - Marrëveshja paraprake.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë Kurum International sh.a, për transferimin e asetëve të Hec “Ulëz”-“Shkopet”, “Bistrica 1” dhe Bistrica 2” në kuadër të marrëveshjes me “IFC”.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e shoqërisë Kurum International sh.a. për Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

VENDIMIN

Nr. 7 Datë 06.02.2014

PËR
MIRATIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË KURUM INTERNATIONAL
SH.A, PËR TRANSFERIMIN E ASETIVE TË HEC “ULËZ”-
“SHKOPET”, “BISTRICA 1” DHE BISTRICA 2” NË KUADËR TË E
MARRËVESHJES ME “IFC”

Anëtarët e Bordit

	Pro	Kundër
Petrit Ahmeti	_____	_____
Adriatik Bego	_____	_____
Entela Shehaj	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____